



SBASHK Arsimimi sot


Korrik, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK pjesë e Kongresit Botëror të Edukimit



Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar



Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut ... (faqe 5)

Flasin ata që u angazhuan rrjedhën e mbarë të pushimeve në bregdetin shqiptar



Kanë arritur në Kompleksin Ndjehemi krenar me respektin dhe mirënjohjen e shprehur nga pushuesit... (faqe 6)

SBASHK i përfaqësuar nga nënkryetarja znj. Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, po qëndrojnë në Buenos Aires-Argjentinë, ku po marrin pjesë në Kongresin e 10-të Botëror të Arsimit (Education International)... (faqe 3)

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, u prit nga zv. ministri i Arsimit, Taulant Kelmendi



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, duke iu përgjigjur ftesës, u takua me zëvendësministrin e Arsimit, Taulant Kelmendi, me të cilin diskutoi për fillimin e vitit të ri shkollor... (faqe 4)

SBASHK pritet nga kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj



Anëtarë të SBASHK-ut të kryesuar nga kryetari z. Rrahman Jasharaj, janë pritur nga kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj me të cilin kanë diskutuar rreth gjendjes aktuale në arsim, sfidat dhe fillimit të... (faqe 6)



Editorial

Një aktivitet shumë i qëlluar i SBASHK-ut



Edhe në verën e vitit 2024 SBASHK-u vazhdoi me aktivitetin tradicional të pushimeve për një numër të konsideruar të anëtarëve nga tërë Kosova që nga çerdhet e deri te universitetet.

Me qëllim që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë sikur edhe viteve tjera, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin dhe kryetarët e nivelit komunal e të universiteteve kishin nisur me kohë përgatitjet dhe kishin kryer me përpikëri çdo detyrë që ndërlidhej me organizimin e këtij aktiviteti tradicional.

Falë këtij përkushtimi, mikpritjes së stafit në “Bonita” dhe sjelljes me plot dinjitet të

pushueseve e pushuesve ky aktivitet u realizua me sukses të plotë dhe pushuesit e ndarë në tri grupe kaluan momente të bukura në bregdetin shqiptar dhe shumë prej tyre përshtypjet i kanë lënë të shkruara dhe ne do të përcjellim disa nga ato në një shkrim të veçantë në gazetën tonë të muajit korrik. Se ky aktivitet është shumë i qëlluar ma kanë thënë të gjithë pushuesit gjatë vizitës që u bëra. Ata më treguan se krahas pushimit kanë zhvilluar edhe biseda me njëri-tjetrin duke bartur edhe përvojat për punën edukative e arsimore e duke analizuar situatën aktuale në arsim.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Gjatë muajit

SBASHK pjesë e Kongresit Botëror të Edukimit



SBASHK i përfaqësuar nga nënkryetarja znj. Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, po qëndrojnë në Buenos Aires-Argjentinë, ku po marrin pjesë në Kongresin e 10-të Botëror të Arsimit (Education International).

Me moton “Rritja e sindikatave tona, ngritja e profesioneve tona, mbrojtja e demokracisë”, Kongresi Botëror 2024 ka mbledhur rreth 1200 delegatë nga e mbarë bota nëpërmjet 383 organizatave anëtare të cilët po përfaqësojnë më shumë se 32 milionë mësues dhe personel mbështetës të arsimit nga 178 shtete.

Gjatë qëndrimit në Buenos Aires nga 27 korriku e deri më sot, përfaqësuesit e SBASHK-ut u takun me shumë delegacione para fillimit të Kongresit dhe pritët që edhe në pesë ditët në vijim të kenë takime edhe me Kryetren e EI, me sekretarin e pergjitheshum si dhe me delegacione të Gjermanisë, Holandës, Italisë, Meksikës e shumë e shumë shteteve tjere anë e mbarë botës.

Në mes të një krize globale arsimore, mësuesit dhe personeli mbështetës arsimor qëndrojnë elastik, duke mishëruar shpresën dhe transformimin Kjo u theksua nga Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) Amina J. Mohammed në fjalimin e saj kyç në Kongresin e 10-të Botëror të Arsimit Ndërkombëtar (EI). “Ky Kongres është një mundësi vendimtare për ne që të bashkohemi, të strategjizojmë dhe mbi të gjitha, të identifikojmë mënyrat për të mbrojtur mësuesit dhe për të rilindur profesionin e mësuesit ndërsa punojmë për të ofruar një të ardhme më të drejtë, më të begatë dhe të qëndrueshme për të gjithë,” tha ajo.

Si Presidente e Education International (EI), Susan Hopgood i afrohet Kongresit Botëror me një



përzierje shprese dhe vendosmërie. Ajo thekson rolin kryesor të IE në formësimin e një të ardhmeje të qëndrueshme dhe adresimin e sfidave globale përmes edukimit publik. Pavarësisht nga një botë që përballet me konflikte, ndryshime klimatike, paqëndrueshmëri ekonomike dhe sulme ndaj demokracisë, Hopgood pohon se vendosmëria e EI për të nxitur përparimin dhe për të mbrojtur demokracinë nuk ka qenë kurrë më e fortë. “Si presidente e Education International, cilat janë mendimet tuaja për Kongresin Botëror? Së pari, kjo organizatë është me shpresë dhe besim. Ne e dimë se kemi një rol të rëndësishëm në ndërtimin e botës së qëndrueshme që duam dhe që bota ka nevojë. Por sytë tanë janë hapur. Ne e shohim botën ashtu siç është, luftën, ndryshimet klimatike, rënien ekonomike, sulmet ndaj demokracisë, autokracitë e shtuara dhe më shumë. Kriza e arsimit nuk po ndodh në vakum. Progresi nuk është i pashmangshëm, ai duhet të luftohet dhe të fitohet kundër kundërshtarëve me burime shumë më të mëdha se ne. Por pavarësisht sulmeve dhe pengesave të vazhdueshme, solidariteti ynë është më i madh se kurrë, dhe ne vazhdojmë të mobilizojmë temat e këtij Kongresi – për të rritur sindikatat tona, për të ngritur profesionin tonë dhe për të mbrojtur demokracinë”, tha ajo.

Më 29 qershor, David Edwards, Sekretari i Përgjithshëm Ndërkombëtar i Arsimit, doli në skenë përpara më shumë se 1200 drejtuesve të sindikatave të arsimit për të reflektuar mbi sfidat dhe arritjet e lëvizjes globale të sindikatave të arsimit në pesë vitet e fundit.

Pavarësisht nga një mori krizash, nga pandemia Covid-19 te urgjenca klimatike, nga luftërat tek autoritarizmi në rritje, arsimtarët kanë qenë në gjendje të krijojnë mundësi të paprecedentë për të avancuar të drejtën për arsimim, të drejtat e punëtorëve dhe demokracinë në mbarë botën. “Zhvillimi, ky përkushtim, ky momentum në terren në mesin e organizatave tona anëtare është i pamohueshëm, sepse ju e dini se kjo është koha jonë. Ne e dimë se sistemet arsimore cilësore, falas dhe me burime të mira nuk janë të pashmangshme. Ne e dimë

se mësuesit me kualifikim të lartë, personeli mbështetës arsimor dhe edukatorët e tjerë nuk janë të garantuar për çdo nxënës në çdo klasë. Duhet të luftohet dhe të mbrohet. Por unë mund t’ju raportoj këtu në dekadën tonë të katërt si federatë se ne kemi ndërtuar njohuritë, reputacionin dhe fuqinë në nivelin më të lartë për të qenë një forcë jo vetëm për arsimin, por për vlerat e të drejtave të njeriut dhe demokracisë rreth botë”, tha Edwards.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, u prit nga zv. ministri i Arsimit, Taulant Kelmendi

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, duke iu përgjigjur ftesës, u takua me zëvendësministrin e Arsimit, Taulant Kelmendi, me të cilin diskutoi për fillimin e vitit të ri shkollor, pakënaqësitë dhe kërkesat e mësimeve karshi Qeverisë.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, kërkoi nga Kelmendi që takime të tilla mes MASHTI-t dhe Sindikatës të ketë më shpesh ngase sipas tij në këtë mënyrë mund të plotësohen kërkesat e mësimeve dhe zgjidhen problemet aktuale në arsim.

Kryetari Jasharaj kërkoi që furnizimi me tekste shkollore këtë vit të bëhet nga MASHTI duke i dërguar tekstet shkollore në shkolla si dhe të ketë libra të rinj për të gjithë nxënësit e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, pra nga klasa 1 deri 9.

Kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj kërkoi nga zv. Ministri Kelmendi që Qeveria të bëjë rritjen e koeficientit për mësime dhe të plotësohen edhe kërkesat tjera të anëtarësisë, të cilat në formë të shkruar ia dorëzoi zv/ministrit Kelmendi. Jasharaj u shpreh se kur ka dialog dhe angazhim për realizimin e kërkesave të anëtarësisë atëherë nuk ka kërkesa për veprime sindikale.

Nga ana e tij, zëvendësministri Taulant Kelmendi premtoi se do t'i shqyrtojë me kujdes kërkesat e SBASHK-ut e pastaj informoi kryetarin Jasharaj për angazhimet dhe përgatitjet që po bënin MASHTI lidhur me vitin e ri shkollor.

Në këtë takim bashkë me kryetarin Jasharaj kanë qenë edhe zyrtari ligjor Blendor Shatri dhe zyrtarja për trajnime dhe informim Drita Vitia Zeneli.



Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut

Aktiviteti tradicional i SBASHK-ut për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptarë për një numër të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve të sindikatës sonë këtë vit u realizua në tri grupe të ndara.

Ata janë ndjerë mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit dhe çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit të bërë me kohë. Pushueset e pushuesit kanë shprehur mirënjohje e falënderime për SBASHK-un edhe gjatë vizitës së kryetarit të SBASHK-ut, por një numër i tyre përshtypjet e tyre i kanë lënë të shkruara në fletoret e përshtypjeve. Në këtë numër të gazetës sonë po shfletojmë ato dhe te ju lexues të nderuar po përcjellim pjesë nga këto përshtypje. Nga to dalluam përshtypjet e thënë përmes vargjeve. Në këtë poezi shprehet krenaria për bukuritë e detit shqiptar dhe mirënjohja e falënderimi për kryetarin, stafin dhe për gjithë pushueset e pushuesit që kishin qëndrim të kulturuar e plot dinjitet gjatë gjithë ditëve të pushimit në ambientet e bukura të “Bonita”.

Edhe përshtypjet tjera që do t’i ruajmë në arkivin e SBASHK-ut shprehin respekt e mirënjohje për koordinatorin për organizim të brendshëm, për stafin dhe për veprimtarët e angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

“Ju jam mirënjohëse për punën e angazhimit e

palodhshëm që keni bërë që ky aktivitet të jetë i organizuar kaq mirë”, shprehet një pushuese.

“Ky aktivitet është shumë i qëlluar dhe shpreh respektin e SBASHK-ut ndaj punës e angazhimit të anëtarësisë në shërbim të arsimitit e edukimit të brezave. Ky aktivitet duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen sepse është dhuratë e çmuar për punëtorët e arsimit, që janë anëtarë të SBASHK-ut”, thuhet në përshtypjet e një pushuesi tjetër.

Kemi veçuar për këtë numër të gazetës sonë edhe përshtypjet e një anëtareje të SBASHK-ut nga Mamusha. Ajo përshtypjet i ka shkruar në gjuhën e vet amtare, pra në gjuhën turke, por edhe në gjuhën shqipe. Ne po përcjellim te ju edhe këto përshtypje.

“Deshta fillimisht të them se jam e lumtur që jam anëtare e SBASHK-ut. Kaluam një pushim të mrekullueshëm Unë dhe shoqja ime u jemi falënderues kryetarit Jasharaj, koordinitorit Ymer Ymeri, stafit dhe gjithë atyre që kontribuuan në këtë aktivitet”, është shprehur kjo anëtare e SBASHK-ut nga Mamusha.

Redaksia e gazetës “Arsimimi sot” falënderon pushuese e pushuesit që kanë lënë përshtypjet e tyre të shkruara dhe ato do t’i ruajmë me kujdes në arkivin e SBASHK-ut.

e baslamadan evel
SHK-un üyesi olduğum
mutluyum. Böyle güzel
organizasyonda yer
alması yer aldığımız
çok güzel harika bir
geçirmiş olduk. Her s
emeli organizasyon
eri çok ilgili kaldığın

një pushim mbresl
zuar duome mire
izatorët dhe udhëheq
e ishëm në shërbim të
mi ishte i ballshëm
tati, shërbimi ishte ç
in e dyluar.
modimi i shite në mire
met e kohë pas kohës
et tjera ishëm argetuere
këbëduere.

11.8.2024
Tirana
Në shpirt mirënjohje dhe falënderimi
për këtë ditë të bukurë pushimi, me
respekt nga anëtarja ME një falënderues
FALANDERIM
Falënderim! Ift për këtë begali
Falënderim për begali tua Më Shqipëri
Për ditët që kaluam pranë detit
Me të dashurën Shqipëri
Falënderim përfaqësuesit tërë ligjer
Shqipëri velen se për të na mësonte
Ligjer e jay tëni çpënuar
Një pushim modest për të na ofruar
Kaluan këtë ditë, na u bërëqam shumë
Me përjetë, ushqim rehati në gjumë
Falënderim! nderuar kryetari
Për ne gjithmonë datë jeshile i porë
Falënderim! Shqipëri
Për secilin që nga një,
Falënderim nga gjithë ata,
që na mësonte në hotelin „Bonita“ V
Me respekt
Shqipëri - satime
Mamusha

Flasin ata që u angazhuan për rrjedhën e mbarë të pushimeve në bregdetin shqiptar

Ndjehemi krenar me respektin dhe mirënjohjen e shprehur nga pushuesit

Tri grupet e pushuesve në bregdetin shqiptar kanë shprehur respekt dhe mirënjohje për organizimin e shkëlqyer të aktivitetit racional të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

Për këtë numër të gazetës sonë kemi biseduar me koordinatorin për organizim të brendshëm dhe me anëtarët tjerë të komisionit që u kujdesën për organizimin dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti për pushuesit, që ishin të ndarë në tri grupe.

Ymer Ymeri tregon se ishin kryer me kohë gjithë përgatitjet për tyë nisur mbarë ky aktivitet. Ai përgëzon për angazhimet gjithë stafin dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, të cilët u angazhuan me përkushtim dhe prandaj ky aktivitet u realizua me plot sukses edhe këtë vit.

“Kemi pasur shumë angazhime, por kemi harruar lodhjen e stresin duke dëgjuar ato që thoshin pushuesit për këtë aktivitet”.

Falënderoj Blendin, Afërditën, Nezin, Tafilin, Kastriotin, Makfren, Ruhanin, Lumnijen dhe Sabitin që kanë kryer detyrat me përpikëri dhe kanë kontribuar që ky aktivitet të kryhet ashtu si duhet dhe që pushuesit të ndihen mirë dhe të kalojnë qaste të bukura në bregdetin shqiptar.

Blendor Shatri- Jam angazhuar bashkë me anëtarët tjerë të komisionit dhe ia kemi dalë që me sukses të organizojmë dhe realizojmë pushimet në bregdetin shqiptar. Ndjem krenar me gjitha ato fjalë mirënjohje

nga pushuesit për SBASHK-un dhe për neve që ishim të angazhuar për rrjedhën e mbarë të pushimeve.

Nezafete Jakupi- Më vjen mirë që pushuesit edhe në grupit të tretë kanë kaluar shumë mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit. Kemi komunikuar vazhdimisht me ta dhe ndjeheshim krenar kur ata shpreheshin me fjalë falënderimi për angazhimin tonë. I përgëzoj pushuesit që me sjellje plot dinjitet kanë ruajtur figurën e mësuesit. Afërdita Mirena- Me kënaqësi u angazhova që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë bashkërisht kemi arritur që ky aktivitet të përfundojë me sukses të plotë dhe me kënaqësi po lexoj përshtypjet e shumë prej pushuesve e pushuesve. I falënderoj për respektin që kanë shprehur për SBASHK-un dhe për angazhimin tonë gjatë gjithë ditëve të pushimit.



SBASHK pritet nga kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj

Anëtarë të SBASHK-ut të kryesuar nga kryetari z. Rrahman Jasharaj, janë pritur nga kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj me të cilin kanë diskutuar rreth gjendjes aktuale në arsim, sfidat dhe fillimit të vitit të ri shkollor. Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj e ka falënderuar të parin e AAK-së për interesimin e tij për gjendjen në këtë sektor të rëndësishëm të shoqërisë, derisa e ka njoftuar edhe me problemet që ballafaqohet arsimi sot.

z. Jasharaj ka shprehur shqetësimin e tij rreth fillimit të mbarë të vitit të ri shkollor, furnizimit të nxënësve me tekste shkollore si dhe kërkesën e mësimdhënësve për fillimin e grevës, nëse për këtë kategori nuk rritet koeficienti i pagës.

Kryetari Jasharaj ka përmendur edhe ikjen e mësimdhënësve nga Kosova dhe problemet që mund të shfaqen në një të ardhme të afërt në këtë drejtim.

Në takim e pranishme ishte edhe nënkryetarja e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, e cila e informoi kreun e

AAK-së, z. Ramush Haradinaj për takimet me sindikatat regjionale të Kosovës dhe shpërndarjen e Doracaktut të përgatitur nga IKD, për hapat për shpalljen e grevës së ligjshme në sektorin publik.

Derisa, nga ana e tij, z. Ramush Haradinaj, ka shprehur përkushtimin për të gjetur zgjidhje në kërkesat e mësimdhënësve dhe fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor. z. Haradinaj po ashtu i ka ndarë 14 prioritete në sferën e arsimit që do të përfshihen në programin zgjedhor të AAK-së 2025-2029. Sipas tij, AAK synon rritjen e pagave për punëtorët e arsimit në të gjitha nivelet për 50% si dhe ngritjen e buxhetit për arsim për 6%.



SBASHK nënshkruan marrëveshje me Klinikën “Olive”

SBASHK ka nënshkruar marrëveshje me Klinikën “Olive”, përmes së cilës u ofron të gjithë anëtarëve të SBASHK-ut dhe familjarëve të ngushtë, shërbime shëndetësore dhe laboratorike me 20 % zbritje.



Marrëveshjen e nënshkruar paraprakisht nga drejtori i kësaj Klinike, Fatmir Sejdiu, sot e nënshkroi Kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj, i cili u shpreh i lumtur për shërbimet e ofruara nga kjo Klinikë për anëtarët e SBASHK-ut, përmes kësaj marrëveshjeje.



Të gjithë anëtarët e SBASHK-pasi të dëshmojnë me kartelën e anëtarësisë se janë anëtarë të SBASHK-ut gëzojnë zbritje 20% në shërbimet laboratorike që kryhen në OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C. (biokimi, dhe hematologji), mjekësi familjare dhe dhënie të terapisë (dhënie infuzioni, dhënie injeksioni, etj). Këto zbritje aplikohen në të gjitha pikat e Olive Clinic (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Suharekë dhe Prizren). Në dep. e radiologjisë ofrohet 20% zbritje vetëm në pikën e Olive Clinic në Mitrovicë.

Shërbimin e certifikatave shëndetësore për anëtarët e SBASHK, “Olive Clinic” do ta ofrojë me çmim 10.00 € nga 15.00 € që është çmimi real. Kjo Klinikë ofron shërbime në disa qytete të ndryshme të Kosovës si: Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Suharekë. E pranishme në këtë nënshkrim të marrëveshjes ishte edhe Menaxherja e shitjes në Klinikën “Olive”, Egzona Maliqi.



Në Pejë u mbajt test i për dy grupe të mësimdhënësve

Në Pejë u organizua testi për mësimdhënësit që e kanë ndjekur trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në tri module: Ëord, Excel dhe Poëer Point.

Mësimdhënësit i vizitoi Kryetari i SBASHK-ut, z. Rahman Jasharaj, i cili u dëshiroi suksese dhe i përgëzoi për punën e palodhshme në arritjen sa më të lartë të performancës në mësimdhënie.

Në organizimin e testit mori pjesë edhe koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, z. Ymer Ymeri, zyrtari Ligjor, z. Blendor Shatri dhe kretari i Sindikatës së nivelit komunal të Pejës, z. Isuf Lajçi.

Testi u organizua në shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët “Dardania” në Pejë, për dy grupe të ndryshme të mësimdhënësve të udhëhequr nga trajneri i caktuar nga SBASHK-u, z. Burim Krasniqi.

